

**ANEKS 6. Objektivat dhe prioritetet e përcaktuara në KBFP 2021-2023 / Kapitulli 32**

Objektivat e vendosura në planin e veprimit për zbatimin e Dokumentit të Politikave KBFP 2021/2023

PIFC / KBFP 2021 - 2023	Plani i veprimit për zbatimin e Dokumentit të Politikave për zhvillimin e metejshëm të kontrollit të brendshëm financiar publik të shqiperisë për periudhën 2021-2023
	1. Mjedisi i kontrollit
OS1.	Mjedisi efektiv i kontrollit
Treguesit:	75% e njesive publike kanë realizuar aktivitetet e parashikuara në planin e tyre të veprimit MFK 75% e strukturave financiare mund të tregojnë se zbatimi i planit të tyre të veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit MFK i ka ndihmuar në ruajtjen e një pjese të buxhetit ose efikasitetit të tjera për institucionin
OS2.	Forcimi i përgjegjshmërisë menaxheriale në njesitë e qeverisjes së përgjithshme dhe përgjegjshmeri e decentralizuar menaxheriale
Treguesit:	75% e institucioneve të proveojnë se menaxheret kanë autoritet, financim dhe informacion mbi menaxhimin për aktivitetet për të cilat janë përgjegjës. 100% e institucioneve të përzgjedhura për asistencë teknike kanë krijuar dhe zbatojnë një sistem të përgjegjësisë menaxheriale duke përdorur procedurat e delegimit në të gjitha nivelet e menaxhereve. 60% e institucioneve të proveojnë që menaxheret janë njoftuar zyrtarisht për përgjegjësitë e tyre, nivelet e autoriteteve etj... 100% e stafit të institucioneve të përzgjedhura për asistencë teknike marrin pjesë në trajnime dhe seminare, dhe si rezultat janë zbatuar ndryshime organizative ose procedurale në institucionet e tyre.
OS3.	Përmirësimi i procesit të planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në nivelin qendror dhe vendor, përmes rritjes së rolit të aktoreve të përfshirë në grupin e menaxhimit strategjik (GMS) dhe ekipin e menaxhimit të projektit (EMP)
Treguesit:	80% e institucioneve me mrefunksionim të GMS dhe EMP pas miratimit të udhëzimeve të rishikuara ku mirepërcaktohen përgjegjësitë dhe proceset e GMS dhe EMP në procesin e përgatitjes së buxhetit me gjurmët e auditimit, 80% e menaxhereve të programit janë trajnuar për udhëzimet e reja dhe zbatimin e tyre
	2. Menaxhimi i riskut
OS4.	Përcaktimi i mekanizmave të mire-organizuar dhe funksional të procesit të menaxhimit të riskut.
Treguesit:	75% e institucioneve të identifikojnë ndryshimet e bera për të ndihmuar arritjen e objektivave si rezultat i informacionit të përditësuar për risqet që raportohen dhe diskutohen çdo takim të GMS-se
	3. Informimi dhe komunikimi
OS5.	Përmirësimi i fushës së kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri
Treguesit:	75% e 7 institucioneve të përzgjedhura për asistencë teknike mund të identifikohen si shembuj të vendimarrjes me të mirë në bazë të informacionit me të saktë financiar të dhene.
OS6.	Vendosja e një sistemi eficient dhe efektiv të informimit dhe komunikimit
Treguesit:	100% e institucioneve të përzgjedhura për asistencë teknike mund të demonstronin përfitimet nga informacioni dhe sistemet e komunikimit të përmirësuar, 100% e menaxhereve brenda institucioneve e marrin informacionin që u nevojitet për të përbushur përgjegjësitë e tyre.
	4. Aktivitetet e kontrollit
OS7.	Aktivitetet e kontrollit nëpërmjet dokumentimit të sistemit të MFK përmes Hartes /manualeve të proceseve të punës dhe gjurmëve të auditimit
Treguesit:	75% e institucioneve që kanë përdorur këto procese për të identifikuar mangësitë ose joefikasitetin e kontrolleve dhe me pas i kanë korrigjuar ose përmirësuar ato.
	5. Monitorimi
OS8.	Monitorimi dhe vlerësimi i përshtatshmërisë, efikasitetit, dhe efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Treguesit:	Prezantimi i metodologjisë për vlerësimin e cilësive së sistemit të kontrollit të brendshëm.
OS9.	Forcimi i rolit të një auditimi të brendshëm funksionalisht të pavarur në sektorin publik
Treguesit:	Kuadri ligjor dhe metodologjik për AB në përputhje me SNAB dhe praktikën profesionale Aftësi dhe njohuri të përmirësuar të audituesve të brendshëm dhe zhvillim të kapaciteteve profesionale të auditimit Auditime të brendshme efektive, në përputhje të plote me standardet, të cilat ofrojnë rekomandime me vlerë të lartë Auditimi i brendshëm është vlerë e shtuar për të audituarit dhe rrit performancën e njesive qeveritare
Aktoret :	Komiteti Drejtues (SC) i Strategjisë së MFP Komiteti Teknik (KT) i Strategjisë së MFP Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP dhe MEF